



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 247, Datë 09.08.2023

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “HYDRO SETA” SH.P.K., NË  
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, 13, dhe nenit 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin, dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.08.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1890/7 prot., datë 04.08.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “HYDRO SETA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr.5, datë 17.01.2019”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “HYDRO SETA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1890 prot., datë 07.07.2023, aplikoi për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhe me vendimin nr. 234, datë 19.07.2023, bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës sipas kërkesës, për një afat 5- vjeçar.
- ERE botoi njoftimin për fillimin e kësaj procedure në median e shkruar (në datat 20.07.2023 dhe 21.07.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.07.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 1890/3 prot., datë 27.07.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar vendimin për fillimin e procedurës dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit për të vijuar me procedurën për rinovim.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1890/5 prot., datë 01.08.2023 dhe nr. 1890/6 prot., datë 02.08.2023 shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues për aplikimin.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “HYDRO SETA” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “HYDRO SETA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar, duke filluar nga data 18.01.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**